

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
 KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dituruar Primitjen/Prodato Received/Delivety	01.06.2023	viti god. year	2023
Organ./Njesia Organ./Jednitca Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojc Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
DM 4557/2023			1/4.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.649/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Malësore Gashi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.649/2022 të datës 18.04.2023 të parashtruar nga ankuesja

kundër organit të punësimit Agjencisë Kosovare të Privatizimit, në çështjen juridike „kontestim konkursi“, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 31.05.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.649/2022 e datës 18.04.2022, e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Vendimi nën shenjen DM 114/2023 i datës 06.04.2023, i Departamentit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

A r s y e t i m

Ankuesja (me tej vetëm ankuesja) me datë 18.04.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit nën shenjen DM 114/2023 të datës 06.04.2023 të Departamentit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me pretendimet ankimore së vendimi i kundërshtuar me ankesë është nxjerrë me shkelje ligjore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje Këshilli), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 26.04.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia

Kosovare e Privatizimit, ndërsa kjo e fundit më datë 12.05.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptime të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka administruar këto prova: Ankesën me numër A.nr.649/2023 e datës 18.04.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër DM 114/2023 të datës 06.04.2023 nga NJBNJ; Vendimin me numër DM 107/2023 të datës 31.03.2023 nga NJBNJ; Komunikimin elektronik të datës 13.04.2023, 12.04.2023, 05.04.2023, ndërmjet ankueses dhe Drejtoreshës së Burimeve Njerëzore; Vendimin me Nr.1538/2020 të datës 23.08.2020 nga Avokati i Popullit; Letër rekomandimin me Nr.369/2020 të datës 24.02.2020 nga Avokati i Popullit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 26.04.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 12.05.2023 nga Agjencia Kosovare e Privatizimit së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Vendimin me Nr.Ref.BD-174-3 të Bordit të Drejtorëve të AKP-së; Konkursin e datës 13.02.2023 me numër të referencës RN00010838; Konkursin e datës 13.02.2023 me numër të referencës RN10969; Komunikimin elektronik të datës 15.02.2023; Listën e aplikantëve e gjeneruar tek SIMBNJ; Aplikacionin e ankueses të datës 22.03.2023 lidhur me rastin e aplikimit për pozitën me numër reference RN00010969; Diplomën e ankueses me Nr.691/45-65 të datës 24.11.2010; Diplomën e ankueses të datës 05.10.2020; Diplomën e ankueses me Nr.4343 të datës 21.03.1989; Certifikatën e ankueses nga ITC; Certifikatën e ankueses nga KIPA-PPRC; Certifikatën e ankueses nga UNMIK për periudhën 13.07.2001; Certifikatën e ankueses nga MSHP për periudhën 21-25 janar 2002; Diplomën e ankueses nga ËIFI-ËKO; Certifikatën e ankueses nga Oxford Language Centre për periudhën 07.02-04.03.2005; Seminarin e datës 21.11.2002 nga SSAI; Certifikatën e ankueses nga Central Fiscal Authority për periudhën 27-31.05.2002; Certifikatën e ankueses me numër Nr.085 të vitit 2020 nga KRPP; Akt emërimit e ankueses me numër reference 160/PRK 2 të datës 18.07.2014; Akt emërimit e ankueses me numër 215/PRK 2 të datës 30.12.2011; Kontratën e ankueses të datës 28.10.2008 tek AKP; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Shkresën zyrtare të datës 21.11.2007 nga UNMIK; Kontratën e ankueses të datës 04.09.2007 nga UNMIK; Kontratën e ankueses të datës 05.12.2006 nga UNMIK; Kontratën e ankueses të datës 23.11.2005 nga UNMIK; Shkresën e emërimit të datës 17.04.2001; Shkresën e emërimit të datës 01.08.2000; Kontratën e ankueses të datës 29.05.2007 nga UNMIK; Kontratën e ankueses të datës 04.09.2007 nga UNMIK; Certifikatën e ankueses të datës 11.07.2002 nga ADCK; Letër rekomandimin për ankuesen të datës 06.12.2007 nga AKM; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të ankueses të datës 31.01.2023; Planin individual të trajnimit të datës 31.01.2023; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të ankueses të datës 13.01.2022; Planin individual të trajnimit të datës 13.01.2022; Formularin për caktimin e objektivave të punës së datës 13.01.2022; Vërtetimin për punësim të datës 21.03.2023 nga NJBNJ; Letrën motivuese të ankueses; Certifikatën mbi denimet penale të ankueses të datës 20.03.2023; Njoftimin e datës 31.03.2023 me numër DM 102/2023 nga NJBNJ; Listën e aplikantëve të aprovuar dhe refuzuar e gjeneruar tek SIMBNJ; Ankesën e ankueses të datës 05.04.2023 e parashtruar tek NJBNJ; Njoftimin e datës 18.04.2023 me numër DM 126/2023 nga NJBNJ dhe listën e aplikantëve të aprovuar dhe refuzuar tek SIMBNJ.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankueses, *sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se Agjencia Kosovare e Privatizimit me datë 13.02.2023 ka publikuar Konkursin e mbyllur me numër reference RN00010969, *për pozitën Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm, klasa drejtues i lartë 3*. Konkursi ka qenë i hapur për aplikim nga data 15.03.2023 deri me datë 22.02.2023 e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja.

Referuar Konkursit me numër reference RN00010969, si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar: - **Arsimi:** *Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 4 vite të studimeve;*- **Përvoja e punës:** *Së paku tetë(8) vite përvojë pune profesionale duke përfshirë së paku pesë (5) vite përvojë pune në pozita drejtuese*. Konkursi ka qenë i mbyllur me të drejtë të aplikimit vetëm nëpunësit civil ekzistues të kategorisë së lartë dhe të mesme drejtuese në të gjithë Shërbimin Civil.

Ne fazën e shqyrtimit paraprak, Departamenti i Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare, me Vendimin nën shenjë DM 107/2023 të datës 31.03.2023 ka refuzuar aplikacionin e ankueses, me arsyetimin se e njëjta nuk ka plotësuar kriteret e përcaktuara me nenin 40 paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht së në konkursin në fjalë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civil ekzistues të kategorisë së mesme dhe të lartë drejtuese, ndërsa pozita e ankueses hynë në katëgorinë e pozitave profesionale.

Ankuesja e pakënaqur me refuzimin e aplikacionit, ka parashtruar ankesë me datë 05.04.2023 tek Departamenti i Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, ndërsa kjo e fundit me Vendimin nën shenjë DM 114/ të datës 06.04.2023 ka refuzuar ankesën e ankueses, me arsyetimin se pozita e ankueses nuk klasifikohet në katëgorinë e nëpunësve civil të nivelit të mesëm ose të lartë por në nivel profesional, andaj e njëjta nuk plotëson kriteret për aplikim për pozitën e shpallur sipas Konkursit me numër reference RN00010969.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të nenit 40 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilat përcaktohet se: "1. *Pranimi në një pozitë të kategorisë së lartë drejtuese bëhet me konkurrim të organizuar për çdo pozitë të lirë. Fillimisht, kanë të drejtë të marrin pjesë në konkurrim vetëm nëpunësit civilë ekzistues të kategorisë së lartë dhe të mesme drejtuese në të gjithë Shërbimin Civil*", si dhe dispozitat e nenit 6 paragrafit 6 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues ku përcaktohet se: " 6. *Njoftimi për shpalljen e konkursit për herë të parë është për nëpunësit civilë ekzistues të kategorisë së lartë dhe të mesme drejtuese në të gjithë Shërbimin Civil.....*" , andaj mbi bazën e këtij përcaktimi ligjor si dhe bazuar në vlerësimin e provave të çështjes përkatësisht dokumentacionit të dorëzuar nga ankuesja me rastin e aplikimit me datë 22.03.2023, Kolegji ka konstatuar së ankuesja është e punësuar në Agjencinë Kosovare të Privatizimit she se e njëjta sipas Akt emërimit me numër Reference 160/PRK 2 të datës 04.08.2014 është emëruar dhe vazhdon të ushtroj pozitën e punës Zyrtar i Prokurimit në Departamentin e Prokurimit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, e cila pozitë sipas nenit 13 të

Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil hynë në klasat dhe emërtesat e pozitive të punës së kategorisë profesionale, kështu që duke qenë së pozita *Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm* hynë në kategorinë për klasën e pozitës **Drejtues i lartë 3** siç përcaktohet me nenin 10 të Rregullores (QRK) Nr.10/2022, Kolegji vlerëson se ankuesja nuk i ka plotësuar kushtet formalo-juridike të këtij konkursi me rastin e aplikimit dhe rrjedhimisht janë të pabazuara pretendimet ankimore të parashtruara në ankesën A.nr.649/2023.

Bazuar në konstatimet si më sipër, rrjedhë se Departamenti i Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me rastin e nxjerrjes së vendimit të goditur me ankesë ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe në këtë mënyrë ka zbatuar drejt ligjin material duke vepruar në pajtim me nenin 40 paragrafin 5 nën paragrafin 5.1 dhe paragrafit 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenin 8 paragrafin 2 dhe 3 të Rregullores (QRK) Nr.01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, i cili përcakton se: "2. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikacionit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak. 3. Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që i plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë konkurrimin në fazën e vlerësimit profesional".

Theksuar si më lartë, Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi*

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.649/2023.

Ardita Perçuku-Shyti

Ardita Perçuku-Shyti
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Ardita Haxhnikaj-Demi
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

